VITI 1865 - HENRY FANSHAWE TOZER



Përgatitur nga Mal Berisha

...KA NJË PROVË BINDËSE QË TREGON SE SHQIPTARËT JANË KOMB I NJË LASHTËSIE TË HERSHME.

"Heronjtë e shqiptarëve janë Aleksandri i Madh, Pirroja dhe Skënderbeu, ndërsa në kohët më të vona përmendet edhe Ali Pasha. Aleksandri lidhet me Shqipërinë nëpërmjet nënës së tij, Olimpia, e cila ishte princeshë epirote."

Henry Fanshawe Tozer (1829–1916) ishte një shkrimtar, mësues dhe udhëtar britanik i njohur. Ai udhëtoi gjerësisht nëpër Greqi dhe territoret e Perandorisë Osmane. Në vitin 1850, kishte përfunduar studimet në **Exeter College**, Oksford. Tozer shkroi për udhëtimet e tij në **Malin Athos**, **malin Olimp**, si dhe për **mirditorët shqiptarë**, të cilët i përshkruan në një libër të botuar në vitin **1865**.

Tozeri e fillon udhëtimin, ashtu si edhe Finley, nga Struga, pikërisht aty ku del Drini i Zi, i cili rend drejt bashkimit me Drinin e Bardhë, për t'u derdhur në Lezhë dhe më tej në detin Adriatik.
"Pamja e kësaj pjese të Liqenit të Ohrit, – thotë ai, – është jashtëzakonisht e bukur. Trofta (korani) e liqenit është një specie e rrallë, dhe peshkimi këtu ushtrohet në përmasa të gjera."

“Vendi i tharjes së peshkut ndodhej pranë Liqenit, afër qytetit të lashtë Lychnida (emri latin i Ohrit të sotëm). Anna Komnena flet me admirim të madh për qindra kanalet, nga të cilat silleshin ujërat përmes argjinaturave dhe kalimeve të mbuluara, që komunikonin me njëri-tjetrin, prej nga buron lumi Drin. Aty kalonte rruga romake **Via Egnatia**, të cilën Straboni e përshkruan si 'e matur me milje dhe e shënuar me piketa'.”

Ai përmend një listë njerëzish të shquar të periudhës romake, emrat e të cilëve ishin të gdhendur në latinisht mbi piketat e asaj rruge historike që lidhte Romën me Kostandinopojën. Henry Tozer e vijon udhëtimin drejt Qukësit, ku kalon një natë në një han të vjetër. Më pas udhëton drejt Xhyrës dhe thotë se “zbritëm nga një shpat në Scampa, duke ndjekur rrugën e lashtë të Via Egnatia”.

Elbasanin ai e përshkruan si një qytet me rreth dhjetë mijë banorë, shumica prej të cilëve ishin gegë. Të krishterët ishin të ritit ortodoks, por ishin aq të persekutuar, sa shpesh detyroheshin të konvertoheshin, sipas parimit: “Aty ku vringëllon shpata, aty është edhe besimi.”

Autori përmend Kullën e Sahatit të Elbasanit, gjë që dëshmon për lashtësinë e saj. Më tej, ai përshkruan Malin e Tomorrit në jugperëndim dhe malet që ndajnë qytetin

nga Tirana. Ndër përshkrimet e tij ndodhet edhe ky fragment mbi natyrën fizike të gegëve në Elbasan:

“Shumica e gegëve janë burra të imët. Ajo që bie në sy në karakteristikat e tyre është qafa e gjatë, fytyra e zgjatur dhe e ngushtë, me tipare të theksuara, shpesh në formë shqiponje, dhe me pak flokë. Ata kanë një vështrim të sertë, si njerëz guximtarë dhe të pamëshirshëm.”

“Shqiptarët e quajnë veten ‘shqiptarë’, dhe ekziston një provë bindëse që tregon se ata janë një komb me lashtësi të thellë. Emri ‘Arnaut’, që u është dhënë nga turqit, është në të vërtetë një formë e shtrembëruar e emrit ‘Albanian’. Dr. Von Hahn, i cili jetoi për shumë vite mes shqiptarëve, në veprën e tij *Albanesische Studien*, beson se ata janë përfaqësuesit më të afërt të mbijetuar të Pellazgëve.”